



**KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA
PROCESVERBAL**

Mbledhja e tretë e Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e mbajtur më datë 30.05.2025 (e premte), me fillim në ora 10:10.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e komitetit, **Samra Kërqagu**. Të gjithë anëtarët e komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ-së OPFAKOS në Rahovec;
3. Informatë nga Drejtoria për Arsim, rreth numrit të psikologëve dhe pedagogëve në shkollat e komunës së Rahovecit;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja: Mirëmëngjesi! Përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot në takimin e tretë të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2025. Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesja: Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është pro? Unanimisht aprovohet edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ-së OPFAKOS në Rahovec:

Lulzim Krasniqi: Faleminderit kryesuese! Së pari ju falënderoj për ftesën në këtë komitet. Një vërejtje të vogël: nuk jemi më OPFAKOS, por jemi bërë organizatë lokale dhe tani jemi OPFKA-RAHOVEC, si organizatë e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kërkesa jonë është adresuar te kryetari i komunës dhe te Drejtoria e Shëndetësisë. OPFKA-KOS daton prej marsit 2004 dhe nga viti 2015 jemi pavarësuar në nivel lokal dhe kemi bërë OPFKA-RAHOVEC. Si organizatë, kemi bashkëpunime me organizata lokale dhe ndërkombëtare. Angazhohemi për të drejtat e prindërve me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e tyre. Vitin e kaluar ka pasur fjalë kinse si organizatë nuk kemi qenë aktivë, por realisht jemi shumë aktivë dhe nuk e di se kush ka bërë më shumë aktivitete se ne gjatë këtyre 20 viteve. Kërkesa jonë kryesore është për një zyre, sepse momentalisht jemi në Qendrën Rinore. Kjo kërkesë për një ambient administrativ është maratonike, të cilën e kemi dorëzuar në drejtorinë përkatëse. Si Komitet për Persona me Aftësi të Kufizuara kërkoj që ta shfrytëzoni ndikimin tuaj dhe të dihet që është urgjente nevoja për ndërtimin e një qendreje për qëndrim ditor për persona me aftësi të kufizuara.

Atdhe Rama: Faleminderit doktor! Propozoj që duhet ta gjejmë një vend të përshtatshëm për zyrë dhe komuna jonë të bëjë zgjidhje për këtë çështje. Zyre ka edhe te Hendikosi!

Selman Shtavica: Përshëndetje për të gjithë! Te Hendikosi janë edhe dy zyre mungesë, sepse aty janë të vendosura 4 shoqata.

Atdhe Rama: Unë thash nëse ka, nëse jo, atëherë është shumë në rregull.

Skender Hazma: Përshëndetje për të gjithë! Propozimet e juaja do të shqyrtohen nga komiteti dhe tutje mund të bëhet edhe zgjidhja.

Lulzim Krasniqi: Mos të harrojmë që Hendikosi është ndërtuar për komunitete. Selmani tha që aty janë 4 shoqata, por dega “Nënë Tereza” nuk është aktive. Shoqatë aktive aty është vetëm Hendikosi.

Selman Shtavica: Protestoj! Zotëriu bëri ndasi kur i përmendi komunitetet, sepse ne nuk i dallojmë njerëzit sipas racës dhe ngjyrës.

Atdhe Rama: Le të fokusohemi në fenomen dhe në trajtimin e barabartë të personave me aftësi të kufizuara. Unë jam për zgjidhje dhe si komitet do ta dërgojmë një shkresë te kryetari i komunës.

Ferat Durguti: Përshëndetje për të gjithë! Kur ta bëjmë kërkesën, a duhet ta bëjmë për zyre apo për depo. Do të ishte më mirë që kërkesa të prezicohet, pasi Luli një herë tha që kemi nevojë për zyrë e më pas edhe për depo.

Lulzim Krasniqi: Realisht, neve na duhet një ambient administrativ, sepse kësaj shoqërie i kam sjell rreth 1 milion euro donacion. Ju paralajmëroj që së pari do të bëjë kërkesë për gjetjen e një lokacioni, e më pas mund të fillojë edhe ndërtimi i qendrës për qëndrim ditor për personat me aftësi të kufizuara.


3. Informatë nga Drejtoria për Arsim, rreth numrit të psikologëve dhe pedagogëve në shkollat e komunës së Rahovecit:

Avni Morina: Faleminderit kryesuese! Sa i përket informatës së kërkuar rreth numrit të psikologëve dhe pedagogëve në shkollat e komunës së Rahovecit, ne kemi 5 psikologë dhe 5 pedagogë. Janë psikologë dhe pedagogë shkollorë dhe jo klinikë. Gjithashtu, i kemi edhe 4 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta dhe për fëmijë që kanë ngecje në arsim. Pesë psikologë janë një në shkollën “Gëzim Hamza – Piktori”, një në Isa Boletini, një në Bekim Iska, një në “Hamëz Thaqi” – Xërxë dhe një në “Katër Dëshmorët” në Ratkoc. Dëshira jonë është që të kemi më shumë psikologë, por nuk kemi kuota nga ministria. Faleminderit!

4. Të ndryshme:

Kryesuesja: Faleminderit drejtor! Atëherë jemi te pika e fundit e rendit të ditës! Nëse dikush ka diçka për të shtuar?... Nëse jo, atëherë shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi

Kryesuesja e komitetit


Samra Kërqagu

